



Analiza vjetore e punës për Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit gjatë vitit që po mbyllet ka qënë e angazhuar në aktivitete të shumta në përmbushje të detyrave të saj funksionale.

Ndër më kryesoret do të përmendnim realizimin e të gjithë aktiviteteve të realizuara në kuadër të Projektit të BE IPA 2008 “Fuqizimi i ZSHDA-së dhe partnerëve të saj”.

Në kuadër të Projektit IPA 2008 “Për forcimin e kapaciteteve të ZSHDA” një ekip me ekspertë nga më të mirët e kësaj fushe kanë përfunduar hartimin e draftit të ri të Ligjit për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me të.

Projekt- Ligji i ri është në përputhje dhe transponon në mënyrë të plotë të gjitha Direktivat e KE. Ai parashikon dhe zbatimin e praktikave më të mira administrative, gjyqësore dhe të zbatimit në tërësi të cilat aplikohen sot në pjesën dërrmuese të vendeve e të zhvilluara të Evropës dhe më gjerë.

Draft -Ligji gjatë periudhës shtator -nentor është konsultuar në një fazë të parë diskutimesh me grupet e interesit dhe me institucionet përgjegjëse Komitetet dhe vërejtjet e mbledhura janë reflektuar në projekt-ligj i cili në formën e tij përfundimtare i është përcjellë Ministrit të TKRS për të përcjellë zyrtarisht për mendim këtë projekt-ligj në ministrinë e linjës..

Si më poshtë vijon do të gjeni në mënyrë të detajuar punën e secilit sektor më vete të ZSHDA-së.

I- Në lidhje me punën një vjecare të Sektorit të Inspektimit dhe Regjistrim-Certifikimit, Ju informoj si më poshte vijon:

1. Sa i takon procesit të Regjistrim Certifikimit dhe pajisjes me pullën artistike të ZSHDA për periudhën Janar-Dhjetor 2011 shënohen këto të dhëna:

Kanë regjistruar dhe certifikuar objektin e veprimtarisë 14 subjekte përdorues të veprave që mbrohen me të drejtë autori dhe të drejta të lidhura nga dispozitat e LDA.

Janë regjistruar dhe certifikuar 48 aplikime për regjistrimin e të drejtave të autorit mbi vepra sipas kategorive të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit Nr. 9380, datë 28.04.2005, "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të cilat i përkasin fushës letrare, artistike dhe shkencore ..

Janë regjistruar dhe certifikuar 50 regjistrime kalim të drejtash nëpërmjet kontratave dhe marrëveshjeve të ndryshme, ku numrin më të madh e përbëjnë kontratat e botimeve, prodhimeve fonografike, etj.

Nga aplikimet e depozituara janë refuzuar një numër i madh praktikash, për të cilat autorët apo subjektet janë njoftuar për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për përfundimin e procesit të regjistrim-certifikimit në Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit.

Përsa i përket pajisjes me Pullën Artistike të ZSHDA-së janë tërhequr nga subjekte të ndryshëm 29 758 Pulla, për fonogramet e prodhuara/shpërndara me të drejta.

2. Sa i takon Inspektimit në total Janar-Dhjetor janë vendosur deri në 21.11. 2011, 150 gjoba dhe deri në fund të dhjetorit në bazë të provave të depozituara nga subjektet e ndryshme për pagesat e kryera te subjekti Sig-Ship, 16 janë depozituar nga Agjencia AKDIE; dhe një vjen nga Akti përfundimtar i lëshuar nga Sektori i Gjykimit Administrativ, dhe deri në fund të vitit mund të arrijë afro 170 gjoba. Ndërsa sa i takon konfiskimeve të kryera në bashkëpunim me Task-Force të DPT, për vitin 2011 janë 2259 copë cd, dvd. Të gjitha masat administrative janë kaluar në titull ekzekutiv por në lidhje me vjeljen e arkëtimit e tyre nuk kemi të dhëna nga organet tatimore.

3. Koshient për një nivel të pandryshueshëm të statistikave për këto tre vite (numri i gjobave është afërsisht i njëjtë) ndërsa në terren janë informuar, zyrtarisht dhe drejtëpërdrejtë, monitoruar e rimonitoruar, me shumë se tre

herë subjekte, problematika ka qenë po e njëjta, që nga viti 2008 kur ndryshoi ligji për procedurat tatimore dhe ekzekutimi e vjelja e gjobave mbeti dhe mbetet problemi kyç i zbatimit të LDA.

Në këtë problematikë, bëjnë pjesë edhe mosidentifikimi i subjekteve, jo vetëm në terren, por edhe me të dhënat e tyre tatimore nga vetë administrata tatimore rajonale. Me dhjetra kërkesa për vënie në dispozicion të të dhënave tatimore, për shumë pak prej tyre jemi pajisur me informacion, çfarë ka bërë të pamundur vendosjen e gjobës.

Gjithashtu në muajt e sezonit veror, u inspektuan dhe gjobitën dhjetra subjekte edhe në qarqet e tjera të vendit, kategoria dicko dhe pub-e, të cilat pasi u kaluan titull ekzekutiv dhe iu dërguan organeve tatimore, këto gjopa nuk u ekzekutuan, pasi subjektet e ndëshkuara kishin mbyllur aktivitetin.

Fenomeni “Sig-Ship” është dhe mbetet ende një nga problemet e mëdha që vazhdon ç`orienton tregun, megjithese i gjobitur dhjetra hera nga inspektorët dhe ende pa u ndëshkuar si duhet nga organet kompetente gjyqësore, duke theksuar edhe mosangazhimin e AAK-ve për të bërë kallzim penal kundër këtij subjekti mashtrues. Problematika është prezent disa herë edhe në institucione e tjera më të larta të zbatimit të ligjit, por pa asnjë rezultat konkret deri më sot.

Përsëri edhe këtë vit shënohen e njëjta kategori e inspektuar, pika shitje-qiradhënie cd, dvd, etj; bare-restorante, clube-pub; radio dhe tv kabllorë; hoteleqë paraqesin problematikë të njëjtë dhe shpesh agresive kundër zbatimit të ligjit, po aq sa edhe specifike në bazë të objektit të tyre të veprimtarisë që ushtrojnë.

Risi përbën inspektimi i tregut për programet kompjuterike, i cili u zhvillua dy herë gjatë këtij viti, në muajin shkurt dhe nëntor-dhjetor, me kërkesën dhe bashkëpunimin e “Microsoft Albania”, të cilët zhvilluan trajnime të inspektorëve lidhur me identifikimin programeve të ligjshme që tregtohen nga pikat e distributorëve dhe shitësve, si edhe ato të instaluara nëpër pajisje.

Problematika paraqitet më e vështirë në këtë rast, pasi pajisjet kompjuterike që tregtohen, në momentin që u shiten blerësve u instalohen programet e ndryshme në mënyrë të kundraligjshme.

Është e pamundur në mungesë të pajisjeve, lexuesve optikë apo të teknologjisë së lartë, të bëhet e mundur jo vetëm identifikimi i rasteve, por edhe specialistëve që mungojnë në stafin tonë, bashkëpunimit të pamjaftueshëm me përfaqësuesit e Microsoft-it në vendin tonë, si edhe strukturat e tjera zbatuese dhe hetuese, duke filluar që nga doganat, nga drejtoritë e hetimit dhe zbatimit të DPT, të krimit ekonomik, pranë Policisë së Shtetit dhe, sigurisht të titullarëve të ligjshëm, të cilët në asnjë rast nuk nisën procedim ligjor ndaj subjekteve distributorë apo shitës të programeve dhe pajisjeve në territorin shqiptar.

Problematika e medias elektronike radio-tv-platforma dixhitale, është një pikë tjetër e nxehtë e gjithë punës inspektuese. Monitorimi ka qenë i vështirë, megjithëse baza e të dhënave ka ardhur nga KKRT dhe megjithëse zyrtarisht i paraprirë me shkresa me thirrjen për zbatimin e ligjit dhe detyrimeve ndaj titullarëve/AAK e licensuara dhe ZSHDA, ka rezultuar se: inspektorët nuk lejohen të hyjnë në selitë e operatorëve radio dhe tv; adresat në terren ndryshojnë nga ato të deklaruara në KKRT; inspektorët refuzohen nga përfaqësues të subjekteve për të njohur dhe pranuar detyrimet e LDA.

Kategoria e subjekteve hoteliere, e cila në bazën e të dhënave nga institucionet shtetërore përfshin mbi 500 subjekte të regjistruar zyrtarisht, mbi 200 të pa regjistruar fare, dhe pjesa tjetër e paformalizuar me asnjë detyrim tjetër ligjor, tatimor-fiskal apo sipas kuadrit ligjor për turizmin, vijon të prezantojë të njëjtën problematikë të pandryshuar që nga fillimi i funksionimit të Zyrës: mungesë vullneti e hotelierëve dhe shoqatës ATA për të pranuar dhe njohur detyrimin ndaj ligjit dhe AAK-ve të licensuara; zvarritja e negociatave për tre vjet dhe pa rezultat; mungesa e mbështetjes nga ana e institucioneve të tjera kompetente që mbikqyrin dhe zbatojnë kuadrin ligjor për turizmin; mungesa e publikimit të tarifave, përveç një agjencie, asaj AKDIE; refuzim i Albautorit për ti publikuar ato, apo më keq mungesa totale e këtyre tarifave nga FMAA.

Dhe së fundi, me gjithë inkurajimin e Zyrës, nuk kemi arritur të kemi një frymë bashkëpunuese ndërmjet vetë agjencive, megjithëse në fillim u angazhuan për të dalë me plan-veprimi të përbashkët dhe si sportel i vetëm përballë përdoruesve, por nuk u zbatua nga vetë palët.

Nga monitorimet gjatë këtij viti më aktivë dhe prezent në terren me stafe monitoruesish, prezantim tarfiash dhe numër subjektësh të pajisur me njoftime, kontrata -autorizime dhe bashkëpunues me ZSHDA dhe Inspektorët,

rezulton vetëm agjencia AKDIE; Agjencia Albautor vetëm me një Drejtor Ekzekutiv dhe pa kapacitete e staf mbështetës që nuk ishte aktiv në terren dhe bashkëpunues me ZSHDA (përmendim këtu kërkesën zyrtare të ripërsëritur të ZSHDA për ti publikuar tarifat online në faqen tonë zyrtare), megjithse propozues i plan-veprimit; FMAA pa sistem tarifor dhe pa kapacitetet dhe stafet e duhura për të vepruar me operatorët e tregut, duke u mjaftuar vetëm me kontratat që lidh QKK dhe vetëm me operatorët e ndryshëm mediatikë TV.

Sa më sipër, me reformimin edhe të kuadrit ligjor për inspektimin dhe Inspektoriatet, si dhe harmonizimit të tij me ligjet e inspektoriatet ekzistuese, në kuadër edhe të hartimit të ligjit të ri për të drejtat e autorit, Inspektorët e ZSHDA kanë hartuar një draft të kundërvajtjeve administrative.

II- Sektori i Gjykimit dhe Administrimit të Ankimeve, ju paraqet sa më poshtë ecurinë e punës së realizuar nga ky sektor gjatë vitit 2011.

1) Proceset administrative:

Gjatë kësaj periudhe janë paraqitur 8 kërkesa ankimore.

- Ankimues Z.Gani Xhengo autor (fotograf) dhe palë të ankimuar Posta Shqiptare sh.a. dhe z. Endi Bulku (piktor). Është mbyllur faza e hetimit administrativ dhe është në përgatitje e sipër shpjegimi përfundimtar.
- Ankimues agjencia FMAA dhe palë të ankimuar Tv “Top Channel”)për përdorim të pautorizuar të sekuencave filmike në spektaklin “Portokalli”). Ky procedim u pezullua në muajin korrik me kërkesë të FMAA-së deri në fund të muajit shtator 2011, për zgjidhjen e konfliktit me mirëkuptim midis palëve. Në procesverbalin e seancës së fundit rezulton se ankimuesi duhet të njoftojë më shkrim ZSHDA-në lidhur me ecurinë e negociatave me palën e ankimuar. Deri në datën e sotme nuk ka njoftim nga kjo agjenci për mbylljen apo vijimin e procedimit. Në fund të këtij muaji ky procedim hyn në fazën e braktisjes sipas nenit 102 të KPA.
- Ankimues Z. Shaban Sinani (autor-studies) dhe palë e ankimuar shtëpai botuese ARGETA-LMG (për botim të paautorizuar të 4 veprave të autorit ankimues). Ky procedim u pezullua në muajin korrik me kërkesë të ankimuesit për një periudhë 6-mujore, për zgjidhjen e konfliktit me mirëkuptim midis palëve. Në procesverbalin e seancës së fundit rezulton se ankimuesi duhet të njoftojë më shkrim ZSHDA-në lidhur me ecurinë e negociatave me palën e ankimuar. Deri në datën e sotme nuk ka njoftim

nga kjo agjenci për mbylljen apo vijimin e procedimit, megjithëse afati 6-mujor i pezullimit përmbushet në fundtë muajit aktual.

- Për ankesën me ankimues agjencia FMAA dhe palë të ankimuar Tv “ Tv KLAN”, nuk nisi procesi administrativ pasi nga komunikimi shkresor me AQSHF-në, rezultoi se konflikti i parashtruar në ankesë kishte në thelb një marrëdhënie kontraktuale midis AQSHF-së dhe palës së ankimuar, shqyrtimi i së cilës shkon përtej kompetencës së ZSHDA-së.
- 4 ankesat e tjera janë paraqitur nga subjekti “Albatrade Plus” kundër subjekteve TV Vizion +, TV Koha, Radio Eagle dhe Club TV. Nga këto ka përfunduar hetimi administrativ për proceset kundër Club TV, TV Vizion Plus dhe TV Koha dhe hartuar shpjegimet përfundimtare. Vazhdon ende procedimi adminstrativ me palë ankimuese “Albatrade Plus” kundër Radio Eagle.

Problematika e ndeshur gjatë shqyrtimit të ankesave:

- Paraqitja e disa kërkesave ankimore të paplota, pra jo në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin e Proçedurave Administrative;
- Mosparaqitja e provave që në seancat e para nga pala ankimuese, për të vërtetuar cënimin e së drejtës së autorit/të drejtave të tjera të lidhura me të, e cila sjell zgjatjen e procedimit;
- Mosdisponimi i adresave të sakta të palëve të ankimuara e cila sjell zgjatjen e procesit administrativ.

2) Proceset gjyqësore:

- 12 Procese gjyqësore Civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë:
- Çështja me palë paditëse z. Mehmet Spahiu, palë të paditur Akademia e Edukimit Fizik, ZSHDA në cilësinë e Palës së Tretë (objekti: shpërblim i autorit për cenim të së drejtës morale dhe ekonomike). Kjo çështje është ende në proces e sipër.
- Çështja me palë paditëse “Kristal Communication” dhe palë të paditur ZSHDA (objekti: kundërshtim i shpjegimit përfundimtar). Kjo çështje është ende në proces e sipër.

- Çështja me palë paditëse Z. Nevzat Bozhanaj dhe palë të paditur ZSHDA, palë e tretë BKT (objekti: kundërshtim i shpjegimit përfundimtar). Kjo çështje është ende në proces e sipër.
- Çështja me palë paditëse Vodafone Albania dhe palë të paditur ZSHDA, (objekti: kundërshtim i gjobës së ZSHDA-së). Kjo çështje është ende në proces e sipër.
- Çështja me palë paditëse Z. Yzeir Llanaj dhe palë të paditur z. Tano Kasëmi, palë e tretë ZSHDA (objekti: shpërblim i autorit për cenim të së drejtës morale dhe ekonomike). Pala paditëse ka tërhequr padinë.
- Çështja me palë paditëse z. Aristidh Ristani, palë të paditur Z. Ramiz Lika dhe shtëpia botuese “Shtjefni”, ZSHDA në cilësinë e Palës së Tretë (objekti: shpërblim i autorit për cenim të së drejtës morale dhe ekonomike). Gjykata ka shpallur vendimin për pranimin e pjesës së kërkesës padisë vetëm kundër z. Ramiz Lika për shpërblim të dëmit moral dhe pasuror të autorit. Nuk është pranuar padia lidhur me shtëpinë botuese “Shtjefni”.
- Çështja me palë paditëse Znj. Mirvjen Kokona dhe palë të paditur z. Nonda Varfi, z. Viktor Bakillari, palë e tretë ZSHDA (objekti: pushim i cenimit, shpërblim i autorit për cenim të së drejtës morale dhe ekonomike). Në muajin korrik u vendos pranimi i kërkesës së palës paditëse për përjashtimin e fjqtares Elona Gjoka. Çështjaka rinisur në muajin tetor me gjyqtare Elona Stavri dhe është ende në proces e sipër.
- Çështja me palë paditëse Kompania “Eurosig” sh.a -ZSHDA, ku pala paditëse “EUROSIG” sh.a ka kundërshtuar aktin administrativ “Shpjegim Përfundimtar” për procesin administrativ Arben Morina - “Eurosig” sh.a. Gjykata ka vendosur kundër aktit të ZSHDA-së dhe çështja është ankimuar në shkallë të dytë.
- Çështja me palë paditëse Afërdita Meçe Shijaku - I paditur QKF, Shoqëria IDA..etj, person i tretë ZSHDA. Është shpallur vendimi ku është pranuar kërkesa e palës paditëse.
- Çështja me palë paditëse Dhimitër Gjika, i paditur Shtëpia Botuese “Erik”, Dëshira Shehu, person i tretë ZSHDA. Është shpallur vendimi ku është pranuar kërkesa e palës paditëse.
- Çështja me palë paditëse Albania Mobile Communication sh.a dhe i paditur ZSHDA, për të cilën vazhdon gjykimi.

- Çështja me palë paditëse Shtëpia Botuese “Dritan” dhe i paditur ZSHDA, Shtëpia Botuese “Morava”. Gjykata ka shpallur vendimin dhe ka rrëzuar kërkesën e palës paditëse.
- 4 procese gjyqësore Civile pranë Gjykatës së Apelit Tiranë:
 - Çështja me ankimues shtëpia botuese “Dritan”, kundër ZSHDA-së dhe shtëpisë botuese “Morava”, për kundërshtim të vendimit të Gjykatës shk. I, e cila nuk pranoi padinë e “Dritan” kundër vendimit të ndërmjetëm të ZSHDA-së. Gj. Apelit shpalli vendimin për lenie në fuqi të vendimit të shkallës së parë, pra në favor të aktit tonë vendim i ndërmjetëm.
 - Çështja me ankimues z. Abaz Tahir Hoxha, kundër znj, Natasha Lako, palë e tretë ZSHDA, AQSHF, për kundërshtim të vendimit të Gjykatës shk. I, e cila pushoi gjykimin për mosparaqitje të palës paditëse.-Gj. Apelit shpalli vendimin për lenie në fuqi të vendimit të shkallës së parë, pra në kundërshtim me interesat e autorit paditës.
 - Çështja me ankimues RTSH kundër ZSHDA-së për Certifikatën e Regjistrimit të së Drejtëssë Autorit lëshuar Z. Fatmir Çepani për videogramin “20 shkurti...”. Ankimi në Gjykatën e Apelit është bërë nga ZSHDA kundër vendimit të shkallës së parë. Apeli ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim.
 - Çështja me ankimues Bledar Sanka, kundër ZSHDA-së, për kundërshtim të vendimit të Gjykatës shk.I e cila nuk rrëzoi kërkesë padinë e paditësit Bledar Saka për pavlefshmëri të aktit “Fletë Gjobë” nr.000110, dt 15.01.2009.etj -Gj. Apelit shpalli vendimin për lenie në fuqi të vendimit të shkallës së parë, pra në kundërshtim me interesat e paditësit.
- 1 proces gjyqësor Penal pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: Prokuroria - ZSHDA, kundërshtim i vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallzimin penal ndaj subjektit Sig-Ship sh.p.k.

3) Procese të tjera gjyqësore:

Gjatë muajit Mars 2011 u ndërmor një iniciativë për dërgimin e ftetë gjobave të pa vjelura të vendosura nga Inspektorët e ZSHDA-së në Gjykatë për lëshim Urdhër Ekzekutimi.

Janë ndjekur seancat gjyqësore për lëshim Urdhër Ekzekutimi të praktikave si më poshtë vijon:

- Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan- Kërkesë për lëshim Urdhër Ekzekutimi për Radio Alpha.
- Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për ndjekjen e 82 praktikave Kërkesë për lëshim Urdhër Ekzekutimi.
- Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë - Kërkesë për lëshim Urdhër Ekzekutimi për Radio Saranda.
- Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë – 2 Kërkesa për lëshim Urdhër Ekzekutimi për Radio Alpo dhe Radio Amantia.
- Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë - Ndjekjen e 16 praktikave Kërkesë për lëshim Urdhër Ekzekutimi.
- Pas dajles së Urdhërave të Ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka përgatitur 18 praktikat për ekzekutim të dërguara pranë Zyrës së Shërbimeve Përmbarimore Tiranë duke ndjekur dhe ecurinë e ekzekutimit të tyre.

4) Shqyrtimi i ankesave të gjobave

Gjatë kësaj periudhe pranë SGJAA janë paraqitur 24 ankimet e mëposhtme për Fletë Gjobat e vendosura nga Inspektorët e SRÇ.

- 20 ankime nuk kanë qënë të plota dhe i është kërkuar ankimuesit të bëjë plotësimet sipas nenit 132 të LDA-së. Në kushtet e mosplotësimit të tyre sipas ligjit, këto 8 ankesa nuk janë marrë në shqyrtim të mëtejshëm. Kështu përfshihen edhe dy ankesat për gjobat e aplikuara kundër subjektit “Sig Ship”, të cilit i është kërkuar sikundër gjithë ankimuesve të tjerë të gjobave, të plotësojnë kërkesat e dispozitës së lartpërmendur.
- Për 4 ankime është bërë shqyrtimi i plotë dhe janë përgatitur vendimet përkatëse për refuzimin e ankesës së gjobës: për Radio “Klea”, “ Radio Top Gold”, subjektin Bar 68 dhe Radio “Muzika Jonë”.

5) Detyra të tjera:

-Ka qënë pjesë mbledhjeve të vazhdueshme të grupit ndër-institucional të kryesuar nga Zv/Ministri i METE-s për hartimin e Raportit e vitit 2011 për Politikën Tregtare të RSH në kuadër të raportit vjetor të Organizatës Botërore të Tregëtisë (OBT). Në këtë kuadër, ka përgatitur raportin me arritjet në sektorin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura për vitin 2010.

-Ka qënë pjesë përbërëse e grupit të punës për Kapitulli 7. Pjesëmarrje në mbledhjen/trajnimin e organizuar nga MIE për këtë kapitull. Plotësimi i draft-planit të masave për këtë kapitull.

-Ka qënë pjesë përbërëse e grupit të punës për Kapitullin 8. Pjesëmarrje aktive në mbledhjet e zhvilluara pranë Autoritetit të Konkurrencës si institucion lider për këtë kapitull.

-Ka përgatitur materiale përfaqësuese të Zyrës për seminarët në kuadër të IPA 2008, të organizuara me përdoruesit në qarqet administrative të vendit.

-Gjithashtu, Sektori i Gjyimit ka përmbytur me efikasitet të plotë edhe punën rutinë administrative të institucionit duke mbajtur korespondencën me subjektet (persona fizikë/juridikë apo agjenci të administrimit kolektiv) si dhe institucionet e ndryshme.

III- Sektori i Monitorimit të Agjencive të Administrimit Kolektiv, Ju paraqet sa më poshtë ecurinë e punës së realizuar nga ky sektor për vitin 2011:

Puna e këtij sektori konsiston në monitorimin e agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit. Duhet theksuar se problemet dhe vështirësitë në lidhje me monitorimin kanë ekzistuar. Sigurisht gjatë 2011 ka patur përmirësime të dukshme sidomos nga Agjencia AKDIE por ka patur dhe shumë aktivitete të tjera të cilat do ti citoj më poshtë në mënyrë më të detajuar duke nisur nga momenti me i rëndësishëm për funksionimin e një agjencie që është Bilanci Vjetor dhe pasqyrimi i të ardhurave:

1. Kontrolli financiar i të ardhurave të krijuara nga agjencitë të të drejtave të autorit

Gjatë vitit 2011 janë shqyrtuar bilancet e të katër agjencive të të drejtave të autorit, të cilat e kanë detyrim ligjor për t'a paraqitur deri më datë 31 mars 2011. Bilancet kanë patur mangësitë e tyre përkatëse dhe u janë bërë me dijeve agjencive, të cilët më pas kanë bërë rregullimet e nevojshme përkatëse.

Sektori i Monitorimit ka shtuar presionet për verifikimin e bilanceve të agjencive në detaj dhe për hir të së vërtetës janë vënë re një sërë parregullsish duke filluar me zbardhjen e të gjithë zërave të bilancit dhe pasqyrimin e tyre.

Duhet theksuar se një pikë më se e rëndësishme është shpërndarja e të ardhurave tek titullarët e të drejtës së autorit.

Procesi i shpërblimit të autorëve nga ana e agjencive është ende i vështirë për t'u arritur plotësisht pasi agjencitë nuk janë transparente në deklarimin e të ardhurave duke "u justifikuar se mungojnë të ardhurat e mjaftueshme për të dhënë këto shpërblime".

Agjencitë nuk kanë kryer detyrimin e mbledhjes dhe shpërndarjes së të ardhurave ndaj komunitetit që ata përfaqësojnë, në emër dhe për llogari të të cilave kanë mbledhur këto të ardhura të deklaruara. Qëllim dhe mision ky që pasqyrohet edhe në ligj.

Vlen për t'u përgëzuar agjencia "FMAA" për shpërndarjes së të ardhurave ndaj komunitetit që ata përfaqësojnë.

Nga ana e agjencisë "AMI" janë deklaruar në total të ardhura nga veprimtaria e përbashkët e të tre agjencive në bazë të marrëveshjes së përbashkët. Deklarimi i të ardhurave është paraqitur pranë zyrës së të drejtave të autorit pa asnjë autorizim konkret për çdo subjekt.

2. Propozimi për ri-licensimin e 2 agjencive të të drejtave të autorit

Janë rishikuar dhe shqyrtuar dosjet për propozimin për ri-licensim të dy Agjencive konkretisht: Agjencia "FMAA", ri-licensuar me datë dt. 04.11.2011, dhe agjencia "AKDIE" ri-licensuar me dt. 05.09.2011.

3. Revokimi i Licencës së Agjencisë "AMI"

Gjithashtu gjatë muajit Tetor janë bërë prezente relacionet informuese për Ministrin e TKRS mbi gjendjet dhe kushtet aktuale të agjencive. Pas një shqyrtimi të bërë nga MTKRS, në lidhje me agjencitë, Ministri i TKRS ka marrë vendimin për revokimin e licences së agjencisë "AMI" / Urdhër i MTKRS nr.249, datë 26.10.2011 (Për më shumë vizitoni faqen zyrtare www.zshda.gov.al)

4. Kontrolli i kontratave/marrëveshjeve/autorizimeve

Spektori ka kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme kontratat/marrëveshjet/autorizimet e lëshuara prej agjencive kundrejt subjekteve të ndryshme, përdorues të pronësisë artistike si dhe verifikimi i tyre

pranë sektorit të rregjistrim- çertifikimit. Agjensitë të cilat kanë dhënë informacion në mënyrë të rregullt mbi këto autorizime janë AKDIE dhe FMAA.

Agjencia ALBAUTOR nuk kanë dhënë informacion mbi autorizimet e leshuara kundrejt përdoruesve, por kanë qënë vetë subjektet të cilat kanë paraqitur vullentarisht keto autorizime.

Nga ana e agjencisë “FMAA” autorizimet janë dhënë në bazë të marrrëveshjes me QKK-në.

5. Shqyrtimi i tarifave për përdorimin e veprave letrare, artistike dhe shkencore të paraqitura nga agjencitë e administrimit kolektiv.

Agjencia “AMI” ka deklaruar tarifat e reja të agjencisë, të miratuara nga Këshilli i Administrimit. Këto tarifa rezultojnë të njëjta ashtu si janë paraqitur në planin tarifor midis tri agjensive.

Gjithashtu dhe “Albautor” dhe “AKDIE” kanë deklaruar tarifat e tyre. “FMAA” operon me tarifat e QKK-së.

Ndërkohë është relatuar tek Ministri i TKRS në lidhje me tarifat e agjensive dhe i është dërguar dhe një pasqyrë përmbledhese e vendeve të rajonit në lidhje me tarifat për të bërë një krahasim me vendin tonë.

6. Propozim për Licensimin e Agjencisë “AMP” (Agjencia për Mbrojtjen e Producentëve Shqiptare)

Me heqjen e Licences, Agjencisë së Menaxhimit Kolektiv të të drejtave të autorit për prodhuesit e fonogramit “AMI”, është depozituar në ZSHDA një dosje për t`u shqyrtuar dhe për t`u paraqitur për licensim tek Ministri i TKRS me emrin Agjencia AMP - Për Mbrojtjen e Producentëve Shqiptare.

Dosja është shqyrtuar nga të gjithë Sektorët e ZSHDA, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre mbi këtë agjenci. Është përgatitur dhe një memo përmbledhese nga Sektori i Monitorimit në lidhje me dosjen e paraqitur.

Është përgatitur dhe relacioni për propozimin e AMP si Agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të prosucentëve, i cili i është dërguar Ministrin për Licensim.

7. Trajnimi i Agjencive nga ekspertë të huaj

Në kuadër të Projektit IPA 2008 janë kryer një sërë aktivitete trajnuese mjaft të larmishme dhe me tematika të gjera për stafet e Agjensive të Menaxhimit Kolektiv si me poshtë vijon:

4 seminare /trajnime për 4 agjensitë e administrimit kolektiv përkatësisht në datat:

- Albautor- 21-25 Shkurt
- Akdie- 28 shkurt - 4 mars
- AMI- 28 shkurt - 4 mars
- FMAA- 23-28 mars

Ekspertët të cilët kanë kryer trajnimet për agjensitë në fjalë, ishin përfaqësues të agjensive simotra në Europë.

PROBLEMATIKA NË LIDHJE ME AGJENSITË E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV

- Bilancet që këto agjenci dorëzojnë pranë ZSHDA-së cdo vit (mars) paraqiten me mangësi të shumta në pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat nuk korrespondojnë me njëra-tjetrën. Megjithë insistimet e Zyrës dhe ndërhyrjet e saj për të marrë një ekspert kontabël për rishikimin e këtyre bilanceve, përsëri këto paraqesin magësi të shumta.
- Mungesa e nje stafi te specializuar; - stafi që është në përbërje të agjensive nuk është i kualifikuar dhe me njohuri te caktuara në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave te tjera te lidhura me te. Zyra ka kërkuar shpesh herë mbështetje të vazhdueshme nga EİPO dhe Komisioni European/TAİEX Programi i Asistencës Teknike, vizita studimore për sfatin e këtyre agjensive.
- Vazhdon ende të jetë e perfshirë në kuadrin e problematikës që paraqesin tri agjencitë e administrimit kolektiv “FMAA” dhe “AMI” (deri në momentin e heqjes së licensës), mungesa e kontakteve dhe e marrëveshjeve të bashkëpunimit reciprok midis secilës prej tyre dhe organizatave ndërkombëtare simotra, pra agjencive të administrimit kolektiv që mbrojnë të drejtat e autorit/të drejta të lidhura me të sipas degës së artit për të cilat janë liçencuar.
- Përcaktimi i tarifave; - Tarifat e propozuara nga agjencitë për përdorimin e kategorive të veprave për të cilat janë liçencuar, vlerësohen si të larta nga përdoruesit e tyre (operatorët ekonomikë). Kjo është një nga arsyet që përdorues të ndryshëm refuzojnë të paguajnë ndaj agjencisë

shpërblimin për të drejtën e autorëve apo të drejtave të tjera të lidhura me të.

IV- Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe me Publikun, relatton si me poshtë këto aktivitete:

Fokusi kryesor ka qënë në implementimin e Projektit IPA 2008 'Asistencë Teknike për forcimin e kapaciteteve të ZSHDA'

Në kuadër të Projektit IPA 2008 janë parashikuar si dhe janë kryer një sërë aktiviteteve trajnuese mjaft të larmishme dhe me tematika të gjera për stafin e ZSHDA-së, për stafet e Agjensive të Menaxhimit Kolektiv, për Organet shtetërore si tatime, dogana, polici, KKRT, për gjyqësorin dhe prokurorinë etj.

Në kuadër të projektit aktivitetet janë si me poshtë vijon:

4 seminare /trajtime për 4 agjensitë e administrimit kolektiv përkatësisht në datat:

- Albautor- 21-25 Shkurt
- Akdie- 28 shkurt - 4 mars
- AMI- 28 shkurt - 4 mars
- FMAA- 23-28 mars

Ekspertët të cilët kanë kryer trajnimet për agjensitë në fjalë, ishin përfaqësues të agjensive simotra në Europë.

Trajnimi i stafit të ZSHDA nga ekspertë të huaj po në kuadër të projektit

28 Mars -1 prill – Trajnimi i stafit në lidhje me tema të caktuara si Shoqëria e Informacionit, Ritransmetimin kabllor dhe kopjen private etj.

Ne kuader te projektit eshte zhvilluar ne Tirane me daten 1 prill 2011 "Seminar mbi rendesine e te Drejtes se Autorit ne zhvillimet ekonomiko-shoqerore te Shqiperise per Autoritetet Shtetërore", me pjesemarrjen e autoriteteve më të larta qeveritare.

Janë organizuar 12 seminare në 12 qarqet kryesore të Shqipërisë me kategorinë e përdoruesve të pronësisë artistike si TV, Radio, Hotele, Operatore Kabllore, Bare, Restorante, klube nate dhe disco etj. "Rritja e ndergjegjesimit per te gjithë perdoruesit e pronesise artistike" ne qarqet me te medha administrative te Vendit.

Është bashkëpunuar dhe është kërkuar ndihma dhe mbështetja e Dhomave Lokale të Tregtisë dhe Industrisë, për organizimin e këtyre seminareve, por

organizimi i ketyre aktiviteteve nëpër rrethe rezulton i vështirë për shkak të mungesës së kontakteve dhe adresave të sakta. Pjesëmarrja në disa prej qyteteve të mëdha ka qënë e pakët, ku pritshmëritë ishin më të mëdha.

Duhet sigurisht një bashkëpunim më i fortë me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, institucion ky, ku kemi nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi.

Konkretisht këto seminare ndërgjegjësimi janë zhvilluar në këto distrikte:

- Tiranë -18 prill 2011
- Durrës - 20 prill
- Lezhë - 27 prill 2011
- Elbasan- 16 qershor 2011
- Fier - 17 qershor 2011
- Gjirokastër - 18 korrik 2011
- Vlorë - 19 korrik 2011
- Berat - 20 korrik 2011
- Shkodër- 17 Tetor 2011
- Kukës -18 Tetor 2011
- Korçë - 14 Nentor 2011
- Dibër - 16 Nentor 2011

Prill 2011: Hartimi i një Plani Zhvillimi Afat-Gjatë të ZSHDA-së.

është punuar për hartimin e një draft Plani zhvillimi afat-gjatë për ZSHDA, me ekspertë të huaj dhe punonjësit e ZSHDA. Ky Draft i miratuar nga MTKRS pritet të zbatohet me hyrjen në fuqi të draft - ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

Prill 2011: Eshte rishikuar Misioni i ZSHDA/strukturat e reja të propozuara dhe përshkrimet e punës per secilin punonjes.

Secili sektor dhe punonjes ka dhene mendime dhe sugjerime perkatese ne lidhje me Misionin e ZSHDA, vizionin dhe pershkrimet perkatese te punes.

26 prill 2011 - Dita boterore e Pronesise Intelektuale - Takim koktejl me komunitetin e artisteve me te mire te vendit.

Aktiviteti eshte organizuar nga ZSHDA ne bashkepunim me Projektin IPA dhe me mbeshtetjen e Ministrise se Kultures, Turizmit, Rinise, ku ishin te ftuar personalitete dhe figura te shquara te artit shqiptar.

5 - 9 qershor 2011 - Nje pjese e konsiderueshme e stafit te ZSHDA zhvilluan një vizite studimore ne Greqi, qëllimi i të cilës ishte njohje me institucionet e te drejtes se autorit dhe agjencine e menaxhimit kolektiv AEPI.

Qershor 27 – korrik 1/ 2011- Trajnimi i stafit te ZSHDA

Trajnim 5 ditor i ngjeshur me stafin e zyres ne lidhje me: Perjashtimet e Kopjes private; Testi tre- hapesh, neni 5(5); menaxhimi dixhital i te drejtes se autorit, e drejta e autorit ne internet, zbatimi ne mjedisin dixhital dhe nje sere temash te tjera me mjaft interes.

5-9 Shtator 2011- Vizitë studimore në Finlandë. Kjo vizitë kryhet në kuadër të projektit dhe moren pjesë një delegacion prej 5 vetash nga stafi i ZSHDA-së, me qëllim përvetësimin e eksperiencave më të mira në fushën e të drejtës së autorit si dhe për të parë shembullin e funksionimit të menaxhimit kolektiv të zgjeruar (extended collective management).

Në datat 14 -15 shtator 2011, në vijim të aktiviteteve të larmishme e të shumta të këtij projekti, u organizua në Tiranë një Seminar Trajnues 2-ditor për administratën e Autoriteteve Shtetërore, për zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të”, konceptuar për t’u zhvilluar vetëm me pjesëmarrjen e autoriteve doganore, tatimore dhe ato policore, struktura të cilat janë pjesë e zinxhirit për zbatimin e legjislacionit për të drejtën e autorit në Republikën e Shqipërisë.

Aktiviteti është konsideruar i një rëndësie të veçantë për sa i takon zbatimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shqipëri, duke patur parasysh problemet e shumta që ekzistojnë në zbatimin e këtyre të drejtave. Lektorët referues të këtij seminari ishin ekspertë të fushës dhe me një eksperiencë të gjerë ndërkombëtare, të cilët trajtuan tema të ndryshme si dhe ndanë praktikat më të mira botërore me autoritetet pjesëmarrës.

Në datat 5-6 Tetor 2011, në Tiranë, u zhvillua një “Seminar Trajnimi 2-ditor mbi Zbatimin e të Drejtës se Autorit për Sistemin Gjyqësor, në Republikën e Shqipërisë”.

Aktiviteti u konceptua për t’u zhvilluar vetëm me pjesëmarrjen e autoriteteve të sistemit gjyqësor në Shqipëri, strukturë e cila është pjesë e zinxhirit për zbatimin e legjislacionit për të drejtën e autorit në Republikën e Shqipërisë. Pjesëmarrja ishte e konsiderueshme. Ne fund pjesëmarrësit u pajisën me certifikata.

22 Nëntor 2011 Dhoma Amerikane e Tregtisë në bashkëpunim me Microsoft Albania organizuan “Konferencën Kombëtare mbi të drejtat e Pronësisë

Intelektuale. Aplikimi i legjislacionit për këto të drejta në Shqipëri”. Te ftuar ishin kompani të mëdha biznesi, autoritete shtetërore dhe studio ligjore. Aktiviteti ngjalli debate të shumta dhe shumë çështje të tjera delikate duke menduar kështu për organizimin e një aktiviteti tjetër të afërt.

Bashkëpunimi me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI)

WIPO ka qënë një partner i rëndësishëm dhe mjaft bashkëpunues gjatë gjithë ekzistencës sonë 4 -vjecare.

Studim fizibiliteti mbi impaktin e ekonomik që industrinë e bazuara në të drejtën e autorit dhe të drejtat që lidhen me të kanë në zhvillimin e ekonomik të Shqipërisë

Me ndihmën dhe mbështetjen e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) ka filluar përgatitja e një “Studimi Kombëtar mbi Kontributin e Industrive të të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të lidhura në Ekonominë Kombëtare të Shqipërisë”, studim i cili do t'i shërbejë Qeverisë Shqiptare për të propozuar politika dhe ndërhyrje institucionale për inkurajimin e rritjes dhe zhvillimin e industrive të bazuara në të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura në vend.

Studimi kryhet nën supervizionin e (WIPO), në vecanti me Sektorin e Industrive Krijuese në koordim me ZSHDA.

Jemi në fazën e mbledhjes dhe e grumbullimit të të dhënave nga Instituti i Statistikave. Procesi rezulton të jetë i vështirë dhe mungesa e informacionit dhe e furnizimit me të dhënat e kërkuar e vështirëson studimin tonë.

Programi i Asistencës Teknike TAIEX – Komisioni Europian

Janë plotësuar formularët e TAIEX dhe i janë dërguar Ministrisë së Integritimit për asistencë për stafin e zyrës, e cila konsiston në Vizitë Studimore, Misioni i Ekspertit dhe Ëorkshop-e.

Marrëdhëniet me publikun

Në kuadër të aktiviteteve të sipërpërmendura është bërë pasqyrimi i këtyre seminareve dhe aktiviteteve, te organizuara në Tiranë, por dhe nëpër rrethe, në disa nga mediat kryesore në vend qofshin këto kombëtare por dhe lokale.

Është bashkëpunuar me sektorët e tjerë dhe me Zyrën e Drejtorit të ZSHDA-së edhe për prononcime të ndryshme e për intervista të botuara në disa nga mediat e shkruara të vendit.

Memorandum Bashkëpunim më Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë

Me date 18 shkurt 2011, midis Zyres Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit.

Qellimi i këtij memorandumi është Informimi dhe Sensibilizimi i kompanive të biznesit, promovimi i të drejtës së autorit dhe i të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit nepermjet shkëmbimit të informacionit midis dy institucioneve, Identifikimi i masave të mbrojtjes së titullareve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura kundrejt konkurrencës së paligjshme dhe piraterisë

Faqja zyrtare (www.zshda.gov.al)

ZSHDA ka një faqe zyrtare më se funksionale, të gjithë punonjësit kanë tashmë adresat zyrtare dhe relatojmë përfundimisht se kjo faqe është efiçente dhe me një informacion mjaft të qartë për çdo kategori të interesuarish.

Faqja up-detohet në mënyrë të rregullt me të gjitha informacionet e duhura.

Duke Ju falenderuar për vëmendjen Tuaj,

DREJTORE

NIKOLETA GJORDENI